



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. AKTI 1931

NR. VENDIMI 1568



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 1931 Regj.Them
Vendimi 1562
Datë Regj. 02.06.2020
Datë Vendimi 23.07.2020.

Nr.

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTARE: Oltjona GOXHA

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Elisabeta Tusha** në Tiranë, sot më datë **23.07.2020**, i dha fund shqyrtimit gjyqësor me dyer të hapura të kërkesës penale Nr.1931 Regj.Them., datë e ardhjes së dosjes pranë gjyqtarës **04.07.2020** që i përket:

KËRKUES:

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga **prokurori Genci Qana**.

TË PANDEHUR:

██████████ biri i ████████ dhe ████████, i datëlindjes 2 ████████, lindur në ████████ dhe banues në ████████ Rr. “██████████”, Pall. pranë ████████████████████”, me gjendje civile i martuar, me gjendje gjyqësore i padënuar, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, i identifikuar nga Gjykata nëpërmjet nga Pasaportë me Nr. Personal ██████████, datë lëshimi ██████████ përfaqësuar nga Av. Olta Myftaraj me nr.7567 license dhe NIPT ██████████, anëtare e Dhomës së Avokatisë Tiranë (me deklaram).

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprës penale “Mbajtja e lokaleve për prostitucion”, parashikuar nga neni 115 i Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Neni 115 i Kodit Penal.

██████████, e bija e ████████ dhe ████████ e datëlindjes ████████, lindur në ████████ dhe banuese në ████████, ████████, pallat pranë “██████████”, kati i ████████-të, me arsim tetë vjeçar, me gjëndje civile e divorcuar, me gjëndje gjyqësore e padënuar, identifikuar me letërnjoftimin me Nr. ████████ datë lëshimi ████████.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “Prostitucioni”, parashikuar nga neni 113/1 i Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Neni 113/1 i Kodit Penal.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Gjykata, pasi administroi, çmoi dhe vlerësojë provat; dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët të cilët kërkuar:

Prokurori: “Deklarimin fajtor të të pandehurit ████████ për veprën penale parashikuar nga neni 115 i K.P dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Aplikimi i nenit 406 të K.Pr.Penale duke e dënuar përfundimisht me 2 vjet burgim. Vuajtja dënimit të kryet në një burg të sigurisë së zakonshme. Deklarimin fajtor të të pandehurës ████████ për veprën penale parashikuar nga neni 113/1 K.P dhe dënimin e saj me 3 muaj burgim. Aplikimi i nenit 406 i K.Pr.Penale duke e dënuar përfundimisht me 2 muaj burgim. Aplikimi i nenit 59 K.Penal. Në bazë të nenit 190/b/c K.Pr.Penale provat materiale të sekuestruara të pandehurit ti kthehen. Shpenzimet lihen në ngarkim të të pandehurve solidarisht”.

Mbrojtësja e të pandehurit ████████: “Përfundimisht kërkojmë deklarin e pafajshëm të të mbrojturit prej meje. Paraqesim dhe disa dokumenta vërtetuese të rrethanave lehtësuese”.

I pandehuri ████████: “Jam dakort me avokaten, unë jam i pafajshëm nuk kam pasur asnjëherë dijeni, ajo që ka thënë ████████ është e pavërtetë”.

E pandehura ████████: “Unë e pranoj akuzën për veprën penale për të cilën akuzohem dhe jam e penduar më ka shtyrë nevoja ekonomike pasi kam pasur djalë sëmure”.

Si dhe pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi;

VËREN SE:

I. Procedura, faktet dhe provat.

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesën për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të pandehurit ████████ i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mbajtja e lokaleve për prostitucion”, parashikuar nga neni

115 i Kodit Penal dhe në ngarkim të të pandehurës [REDAKTUAR], e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prostitucioni”, parashikuar nga neni 113 i K.Penal.

2. Gjykata paraprakisht konstatoi se, bazuar në nenet 69, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale, çështja hynë në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të kësaj gjykate gjykimi i saj.
3. Nga ana e të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre, në seancë paraprake ishte bërë kërkesë për të proceduar me gjykim të shkurtuar. Kërkesë e cila u konfirmua prej tyre edhe në seancë gjyqësore. Në këto kushte Gjykata pasi dëgjoi parashtrimet e prokurorit dhe shqyrtoi provat e ndodhura në fashikullin e procedimit penal në ngarkim të të pandehurve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], konstatoi se nga ana e të pandehurve nuk u kërkuan të deklaroheshin akte të pavlefshme apo prova të pa përdorshme, njëkohësisht nga gjykata nuk u konstatuan kryesisht akte absolutisht të pavlefshme në kuptim të nenit 128/a të K.Pr.Penale, apo prova të pa përdorshme, gjithashtu gjykata konstatoi se provat në ngarkim të tyre ishin të plota dhe çështja penale mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet, ndaj në referim të nenit 405/7 të K.Pr.Penale vendosi të pranonte kërkesën e e secilit të pandehur për të proceduar me gjykim të shkurtuar.
4. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr.1789/3 të vitit 2018, për veprën penale “Mbajtja e lokaleve për prostitucion”, parashikuar nga neni 115 i Kodit Penal, në ngarkim të pandehurit [REDAKTUAR] dhe për veprën penale “Prostitucioni”, parashikuar nga neni 113 i K.Penal në ngarkim të të pandehurës [REDAKTUAR].
5. Nga shqyrtimi tërësor i akteve të këtij procedimi penal Gjykata çmon të provuar faktin si më poshtë vijon: I pandehuri [REDAKTUAR] është administrator i qendrës estetike “Megu Center”, të ndodhur në rrugën “Margarita Tutulani” Tiranë, ku ka qenë e punësuar edhe e pandehura [REDAKTUAR]. Në datën 01.06.2018, rreth orës 19.00, në këtë qendër estetike është futur për të bërë masazh, personi me inicialet A.H, i autorizuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve simuluese. Masazhi i tij është kryer nga e pandehura [REDAKTUAR] dhe personi i autorizuar ka regjistruar gjithë komunikimin “audio” që ka patur me të. Nga tërësia e komunikimit midis tyre, rezulton qartë që e pandehura [REDAKTUAR] kundrejt një pagese i ka ofruar personit të autorizuar, shërbimin seksual të “seksit gojor”, të cilin më pas e ka realizuar plotësisht. Gjithashtu nga biseda ndërmjet tyre rezulton ndër të tjera se e pandehura është pyetur nga personi me inicialet A.H, në lidhje me pagesën e masazhit dhe ajo i është përgjigjur se kushton 3.000 lekë/orë, se pagesa kryej po tek ajo. Pasi ai i ka bërë me dije se dëshironte t’i linte një kafe, pra pagesë shtesë përveç tarifës së masazhit, ajo i është përgjigjur se kur lë më shumë lekë tek recepsioni thonë pse ky ja jep këto lekë, pse lë më shumë, ndaj klientët pagesat i lënë gjithmonë në dhoma.

6. Në datën 19.09.2018, rreth orës 15:30', punonjësit e policisë kanë shkuar për kontroll në ambientet e qendrës estetike “Megu Center” dhe ambientet e saj janë gjetur punonjëset [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Nga kontrolli dhe kqyrja e ambienteve të brendshme të qendrës, në një nga dhomat janë gjetur 6 (gjashtë) prezervativë të pakeluar, të pahapur me mbishkrimin “Durex” (prej të cilëve dy me ngjyrë rozë, dy me ngjyrë bojqielli dhe dy me ngjyrë lejla) dhe një kuti kartoni boshe për prezervativë, me mbishkrimin “Durex” (me ngjyrë portokalli dhe rozë), të cilat ndodheshin tek një raft me ngjyrë të bardhë. Në korridorin midis derës kryesore nga veriu dhe dhomës ku janë gjetur sendet e mësipërme, tek një nga koshat e plehrave është gjetur një prezervativ i hapur dhe i përdorur, brenda të cilit ndodhej një lëng i bardhë i ngjashëm me spermë, i cili ndodhej së bashku me disa letra të bardha që përdoren për pastrim. E pandehura [REDAKTUAR] e pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për hetimin ka shpjeguar ndër të tjera se kishte filluar punë në qendrën e masazhit “Megu Center”, para rreth dy muaj e gjysëm. Ajo është takuar me pronarët e qendrës, shtetasit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të cilët i kanë shpjeguar se masazhi ju bëhej klientëve me mbathje një perdorimshe dhe me peshqir. Ky masazh bëhej në gjithë trupin dhe masazhet kushtonin 1150 lekë/ora, ku ajo përfitonte 400 lekë muajin e parë të punës dhe 500 lekë muajin e dytë, ndërkohë që ka mundur të gjejë klientë fiks, pasi me gjithçka merrej [REDAKTUAR]. Deklaruesja ka pranuar se ju ka ofruar seks oral dhe ka masturbuar klientët që shkonin në qendrën e masazhit. Në vijim të hetimit, e pandehura [REDAKTUAR], është pyetur si person ndaj të cilit zhvillohen hetime ku ka konfirmuar ndër të tjera se ka kryer disa herë seks oral dhe ka masturbuar klientet që vinin në qendrën estetike “Megu Center”. Klientët telefononin [REDAKTUAR] dhe ai planifikonte oraret, të cilat j’u thoshte me telefon asaj. Klientët e siguruar nga [REDAKTUAR] pasi vinin në qendrën e masazhit kur kërkonin që përveç masazhit t’u ofrohej seks oral ose masturbim, paguanin edhe për masazhin edhe për shërbimin seksual. Ajo ka deklaruar se nuk e kishte diskutuar ndonjëherë me [REDAKTUAR] këtë fakt pasi i vinte turp dhe ka qenë thjesht një marrëveshje në heshtje midis saj dhe klientit...”. Në deklaratimet e datës 11.07.2019, e pandehura [REDAKTUAR] pasi ka dëgjuar regjistrimin e bisedës midis punonjësit të autorizuar dhe një punonjëse të qendrës, ka konfirmuar se kishte qenë pikërisht ajo punonjësjë që kishte realizuar komunikimin me klientin...”.
7. Gjatë hetimeve është pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për hetimin shtetasja [REDAKTUAR] e cila ka shpjeguar ndër të tjera se prej 5 muajsh është e punësuar në qendrën e masazhit “Megu Center” dhe këtë vend pune e ka gjetur nëpërmjet rrjeteve sociale, ndërsa në intervistë për punën e ka marrë i pandehuri [REDAKTUAR]. Klientët i kanë kërkuar t’u ofroj shërbime seksuale kur ju bënte masazh, por ajo i ka refuzuar. Pronari i qendrës është [REDAKTUAR], i cili ja u ka bërë të qartë se do t’i pushonte nga puna nëse do të bisedonin se çfarë bëhet në qendrat e masazhit. Pronarët e qendrës nuk i kishin kërkuar në mënyrë direkte që t’i ofronte shërbime seksuale klienteve, por i kanë thënë se klienti duhet të ndihet i kënaqur. Ajo ka deklaruar gjithashtu se në një moment i pandehuri [REDAKTUAR], i ka thënë asaj që *“nëse klienti i kërkon shërbime ekstra si masturbim ose seks oral, ti bëje njëherë se nuk të gjen gjë”*, por ajo ka refuzuar. Më pas, ai ka vazhduar duke i thënë se *“nëse do vazhdojë mos t’i kënaq klientët nuk do e ketë të gjatë në këtë punë”*.

8. Nga kqyrja e pamjeve të kamerave të sigurisë evidentohet se letrat e pastrimit në mes të të cilave u gjet edhe një prezervativ i përdorur, janë hedhur në kosh nga punonjëse të qendrës, por nga këto pamje dhe deklaratimet e vetë punonjëseve nuk mund të përcaktohet se cila është punonjësja që ka hedhur në kosh këtë prezervativ.
9. Sa më sipër cituar me vendimin Nr.1797 akti datë 29.09.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka caktuar masën e sigurimit personal “Arrest në burg” për të pandehurin [REDAKTUAR]. Me vendimin Nr.1797/1 akti dat 18.10.2018, në seancën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve të caktimit të masës së sigurimit dhe nevojat e sigurimit, ndaj të pandehurit Mentor Musaraj është caktuar masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 të K.Pr.Penale. Me vendimin e organit të akuzës datë 17 Shkurt 2020, shtetasi [REDAKTUAR] është akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 115 i Kodit Penal.
10. I pandehuri [REDAKTUAR], nuk e ka pranuar akuzën në ngarkim të tij, si gjatë hetimit dhe në gjykim. Me vendimin e organit të akuzës datë 17 Shkurt 2020, shtetasja [REDAKTUAR] është akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal. E pandehura ka pranuar akuzën si gjatë hetimeve paraprake ashtu edhe në seancë gjyqësore, duke i qëndruar deklaratimeve të dhënë gjatë fazës së hetimeve.
11. Sa më sipër, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesën me objekt si në hyrje të këtij vendimi.

II. Vlerësimi i Gjykatës.

12. Në lidhje me akuzën për veprën penale “Mbajtja e lokaleve për prostitucion” parashikuar nga neni 115 i K.Penal, në ngarkim të të pandehurit [REDAKTUAR], ajo nuk qëndron dhe i pandehuri duhet të deklarohet i pafajshëm në zbatim të nenit 388 gërma d e K.Pr.Penale.
13. Gjykata, thekson faktin se, për të pasur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive. Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë atëherë kur ekzistojnë të katër elementët e saj: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Nëse mungon njëri prej këtyre elementëve, vepra penale nuk ekziston. Prandaj, në çështjen konkrete, Gjykata, duhet të shohë e të verifikojë, ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti. Figura e veprës

penale, pasqyron formën juridike të veprës penale për rastin konkret. Nëse nuk provohet qoftë edhe njëri nga këta elementë personi, nuk mund të dënohet.

14. Vepra penale ***“Mbajtja e lokaleve për prostitucion”***, parashikuar nga neni 115 i K.Penal parashikon se: *“Mbajtja, shfrytëzimi, financimi, dhënia me qira e lokaleve për ushtrim të prostitucionit, denohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet”*. **Objekt** i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ndalimin e ushtrimit të prostitucionit dhe favorizimin e tij me çdo formë, për ruajtjen e paprekshmërisë morale dhe të dinjitetit të njeriut, të mbrojtura me legjislacionin tonë penal nga veprimet kriminale, dhe si të tilla paraqesin rrezikshmëri shoqërore. Në rastin konkret nuk rezulton e provuar që ky objekt të jetë cenuar nga i pandehuri [REDACTED].
15. **Nga ana objektive** kjo vepër penale kryhet nëpërmjet mbajtjes, shfrytëzimit, financimit apo dhënies me qira të lokaleve (çdo lloj ambjenti) për ushtrim të prostitucionit. **Subjekti**, i figurës së kësaj vepre penale, duhet të plotësojë dy kritere ekskluzive ligjore (condicio sine qua non): i) Të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe ii) të jetë i përgjegjshëm përpara ligjit.
16. Në lidhje **me anën subjektive** të figurës së veprës penale ***“Mbajtja e lokaleve për prostitucion”***, Gjykata vlerëson se ky element i figurës së veprës penale lidhet me qëndrimin psikik që mban personi kundrejt veprës së kryer prej tij. Faji, pa të cilin nuk mund të ketë përgjegjësi penale ***“nullum crimen, nulla poena sine culpa”*** është element i përgjegjësisë penale i cili parashikohet shprehimisht në nenin 14 të Kodit Penal. Ai përmban në vetvete dy momente: *atë intelektual* dhe *atë që lidhet me vullnetin*. Për të qenë para veprës penale ***“Mbajtja e lokaleve për prostitucion”***, të parashikuar nga neni 115 i K.Penal, duhet që i vepra penale të kryhet me dashje direkte dhe me qëllimin e posaçëm për të nxjerrë përfitim material nëpërmjet marrjes së një pjese të parave të fituara nga personi që ushtron prostitucionin.
17. Gjykata e gjen me vend të theksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t’i krijojë gjykatës bindjen ***“përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”*** se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri. Sipas Vendimit Unifikues Nr. 7 të datës 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: *“Për vendimin përfundimtar lidhur me themelin e akuzës, gjykata disponon bazuar në bindjen e saj mbështetur në prova që vërtetojnë ose jo akuzën, pra jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Asnjë provë nuk mund të ketë një vlerë të paracaktuar, si në drejtim të fajësisë ashtu edhe të pafajësisë.”*. Pra, në procesin penal, organit të akuzës i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çdo element që përbën veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri. Nga ana e tij, i pandehuri nuk ka asnjë detyrim që të provojë pafajësinë e tij, megjithatë, ai gëzon të drejtën të mbrohet në procesin penal, në përputhje me procesin e rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Lidhur me standardin e vlerësimit të provave GJEDNJ, **në çështjen Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë** shprehet se: *“Për të vlerësuar provat e faktit, Gjykata adopton standardin e*

të provuarit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, por shton se prova të tilla duhet të ndiqen nga bashkëekzistenca e deduktimeve përkuese, mjaftueshmërisht të fortë dhe të qartë ose nga prezumime të njëjta e të pakundërshtueshme të faktit”.

18. Gjithashtu, për sa i përket standardit të provueshmërisë në procesin penal, Gjykata mban parasysh jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë. Kështu, në vendimin Nr. 196, datë 12.06.2013 Kolegji Penal i Gjykatës Lartë, ndër të tjera shprehet: “Kolegji Penal risjell në vëmendje edhe vendimin që i përket çështjes “Breukhoven kundër Republikës Çeke”, nr. 44438/06, datë 21.07.2011 kur, GjEDNj përvijon jurisprudencë të qartë, në lidhje me mundësinë dhe vlerën e përdorimit të akteve, si dhe kualifikimit të akuzave nga ana e gjykatave të faktit. “Sipas jurisprudencës së krijuar nga gjykata, të gjitha provat duhet të merren në një seancë publike, në prani të të akuzuarit, me qëllim të mundësisë së kundërshtimit të tyre. Ka përjashtime nga ky parim, por ato nuk duhet të shkelin të drejtat e mbrojtjes, që sipas rregullit të përgjithshëm, të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 3 (d) të nenit 6, kërkojnë që të pandehurit t'i jepet një mundësi e përshtatshme dhe e duhur, për të paraqitur kundërshtimet e rastit dhe për t'i bërë pyetje dëshmitarit, si në fazën e deklarimeve ose në një fazë të mëvonshme. **Në veçanti, të drejtat e mbrojtjes kufizohen, në një masë që është në kundërshtim me kërkesat e nenit 6, nëse dënimi është i bazuar vetëm, ose në një mënyrë vendimtare, në deklaratimet e një dëshmitari, për të cilat i akuzuari nuk ka pasur mundësi të vijë në dijeni dhe t'i kundërshtojë gjatë hetimit ose gjykimit** (shiko dhe A.M. kundër Italisë, nr. 37019/97, § 25, ECHR 1999-IX). (“Breukhoven kundër Republikës Çeke”, nr. 44438/06, datë 21.07.2011, §43).”, ndërsa në vendimin Nr. 201, datë 05.07.2012 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë shprehet se: “...37. Një konkluzion i tillë i këtij Kolegji bazohet në nenin 152/1 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar dhe duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor. **Kjo do të thotë se fajësia e të pandehurit në një proces penal nuk mund të konkludohet duke u bazuar vetëm në një provë të vetme, e pa mbështetur kjo me prova të tjera më tepër kur ajo nuk provon qartësisht fajësinë e të gjykuarve.** Nëse do të konkludohej me një provë të vetme, atëherë kësaj prove do t'i jepej vlerë e paracaktuar, gjë që është në kundërshtim me kërkesat e nenit 152/1 të Kodit të Procedurës Penale dhe në këtë rast nuk do të **kishim çmuarje të provave**, gjë që është kërkesë e detyrueshme kësaj dispozite.”. Nga përmbajtja e këtyre vendimeve rezulton se askush nuk mund të dënohet me një provë të vetme, e cila nuk lidhet me prova të tjera.
19. Gjykata çmon se, është fakt i njohur që procesi i çmuarjes së provave është proces i ndërlikuar dhe kompleks, pasi përbërës të tij janë komponentë sa juridiko-faktikë, aq edhe të brendshëm, psikologjikë, nga të cilët duhet të udhëhiqet dhe nga i cili ndikohet trupi gjykues në formimin e bindjes së brendshme, pas shqyrtimit prej tij, në tërësi, të provave të administruara gjatë gjykimit, prova këto që doemos duhet të jenë marrë në zbatim të kërkesave të nenit 151 të K.Pr.Penale. Në analizën e provave, gjykata duhet të niset nga parimet bazë për vlerësimin objektiv të tyre dhe kërkesat e nenit 152 të K.Pr.Penale, sipas të cilit përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të provave i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor, nuk ka vlerë të paracaktuar dhe se ekzistenca e një fakti mund të nxirret edhe nga indiciet, kur ato janë të rëndësishme dhe në përputhje me njëra tjetrën. Është e kuptueshme

që, në bazë të nenit 380 të K.Pr.Penale, për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor, por njëkohësisht gjykata është e detyruar të paraqesë e të arsyetojë në vendimin e saj krahas provave mbi të cilat bazon vendimin edhe provat e tjera që i konsideron të pa pranueshme.

20. Në rastin konkret është e qartë se fajësia e të pandehurit nuk mund të deduktohet vetëm nga deklaratimet e shtetasës [REDAKTUAR] për sa kohë ato nuk janë të lidhura me prova të tjera. Në lidhje me indicjet e pretenduar nga organi i akuzës, Gjykata në rastin konkret vlerëson se ato nuk janë të qarta të sakta dhe që të përputhen me njëra tjetrën. Kjo pasi ashtu sikurse citohet edhe vet nga organi i akuzës, personi me inicialet A.H i autorizuar nga prokurori për të kryer veprimin hetimor me të pandehurën [REDAKTUAR], nuk rezulton në asnjë moment që të ketë komunikuar direkt me të pandehurin [REDAKTUAR] në lidhje me masazhin, pagesën e tij apo shërbimet seksuale. Pagesa e masazhit nuk i është kryer të pandehurit [REDAKTUAR], por i është kryer direkt të pandehurës [REDAKTUAR]. Ai ka komunikuar direkt me të pandehurën dhe në bisedën “audio” të regjistruar nga personi i autorizuar rezulton qartë që e pandehura [REDAKTUAR] kundrejt një pagese i ka ofruar personit të autorizuar, shërbimin seksual të “seksit gojor”, të cilin më pas e ka realizuar plotësisht. Gjithashtu nga biseda ndërmjet tyre rezulton ndër të tjera se e pandehura është pyetur nga personi me inicialet A.H, në lidhje me pagesën e masazhit dhe ajo i është përgjigjur se kushton 3.000 lekë/orë, se pagesa kryej po tek ajo. Pasi ai i ka bërë me dije se dëshironte t’i linte një kafe, pra pagesë shtesë përveç tarifës së masazhit, ajo i është përgjigjur se kur lë më shumë lekë tek recepsioni thonë pse ky ja jep këto lekë, pse lë më shumë, ndaj klientët pagesat i lënë gjithmonë në dhoma. Pra është e qartë se çmimi i masazhit është caktuar nga e pandehura [REDAKTUAR], pagesa është bërë pranë saj dhe shërbimi seksual është ofruar prej saj, pa pasur dijeni i pandehuri [REDAKTUAR].
21. Gjithashtu nga aktet e ndodhura në dosje rezulton se nga kontrolli dhe kqyrja e ambienteve të brendshme të qendrës, **në një nga dhomat** janë gjetur 6 (gjashtë) prezervativë të paketuar, të pahapur me mbishkrimin “Durex” (prej të cilëve dy me ngjyrë rozë, dy me ngjyrë bojqielli dhe dy me ngjyrë lejla) dhe një kuti kartoni boshe për prezervativë, me mbishkrimin “Durex” (me ngjyrë portokalli dhe rozë), të cilat ndodheshin tek një raft me ngjyrë të bardhë. Nga ana e organit të akuzës nga njëra anë evidentohet fakti që ato janë gjetur në një dhomë masazhi, ambjent ky privat në të cilin kanë akses masazhoret dhe klientët, kjo referuar edhe deklaratimeve të personave që kanë dijeni për veprën penale dhe nga ana tjetër prezumohet dijenia e të pandehurit për ekzistencën tyre pa pasur asnjë provë apo indicje për të provuar dijenin e tij për ekzistencën e tyre dhe se ato përdoren nga punonjëset e tij me klientët.
22. Njëkohësisht rezulton se në koridorin midis derës kryesore nga veriu dhe dhomës ku janë gjetur sendet e mësipërme, tek një nga koshat e plehrave është gjetur një prezervativ i hapur dhe i përdorur, brenda të cilit ndodhej një lëng i bardhë i ngjashëm me spermë, i cili ndodhej së bashku me disa letra të bardha që përdoren për pastrim. Nga organi i akuzës evidentohet

se gjatë hetimve nuk është bërë e mundur të evidentohet se nga cila prej punonjëseve është përdorur ai.

23. Mosdijenja e të pandehurit [REDAKTUAR] në lidhje me veprimtarinë që kryente e pandehura [REDAKTUAR] apo punonjëset e tjera, jo vetëm që rezulton e qartë nga bashkëbisedimi audio i saj me personin e autorizuar nga prokurori me inicialet A.H, por edhe nga deklaratimet e saj e pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime ku ajo ka deklaruar se nuk e kishte diskutuar ndonjëherë me [REDAKTUAR] faktin që klientët kërkonin shërbime seksuale pasi i vinte turp dhe ka qenë thjesht një marrëveshje në heshtje midis saj dhe klientit.
24. Gjykata vlerëson të theksoj se, për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: *“1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit.”*. Lidhur me kuptimin i këtij parimi kushtetues, Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 57, datë 21.12.2012, ndër të tjera shprehet se: *“Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është **in dubio pro reo, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit** dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza.”*. Kur vihet në dyshim kualifikimi i faktit (“akuzës”, “veprës penale” për të cilën akuzohet, që nënkupton një veprim, sjellje dhe fakt,) ky duhet bërë në favor të të pandehurit. **Në bazë të këtij parimi pranohet se kur gjykata e shpall të pandehurin të pafajshëm, ajo nuk duhet të bindet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. I pandehuri shpallet i pafajshëm atëherë kur organi i akuzës nuk ka arritur të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm në gjykatë se i pandehuri e ka konsumuar veprën penale në të gjithë elementët e saj përbërës ose kur ekziston një dyshim për akuzën, i cili sipas parimit të njohur *in dubio pro reo*, çmohet nga gjykata në favor të të pandehurit.**
25. Sa më sipër Gjykata konkludon se në zbatim të nenit 388 pika d e K.Pr.Penale i pandehuri Mentor Musaraj duhet të deklarohet i pafajshëm për veprën penale *“Mbajtja e lokaleve për prostitucion”* parashikuar nga neni 115 i K.Penal, pasi nuk provohet që ta ketë kryer atë.
26. Në zbatim të nenit 389 të K.Pr.Penale, deklarohet heqja e masës së sigurimit personal *“Arrest në shtëpi”*, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr.1797/1 Akti, datë 18.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

27. Në lidhje me akuzën ndaj të pandehurës Anila Dervishaj për kryerjen e veprës penale “*Prostitucioni*”, parashikuar nga neni 113 i K.Penal. Kjo dispozitë parashikon se: “*Ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet*”. Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton se, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme, për një marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç është ajo e vendosur nga shteti për të garantuar normat e moralit të shoqërisë sonë, të cilat janë në kundërshtim të plotë me dukurinë negative të prostitucionit. Cenimi i kësaj marrëdhënieje nga shtetasit, pavarësisht nga shkaqet, përbën krim dhe pas sjell përgjegjësi penale.
28. Sipas nenit 113 të K.Penal, që të ekzistojë vepra penale e parashikuar nga ky nen duhet që: të ekzistojë **objekti** i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ndalimin e ushtrimit të prostitucionit me çdo formë, për ruajtjen e paprekshmërisë morale dhe të dinjitetit të njeriut, të mbrojtura me legjislacionin tonë penal nga veprimet kriminale, dhe si të tilla paraqesin rrezikshmëri shoqërore. Nga **ana objektive**, autori i veprës penale me veprime aktive, të kundërligjshme duhet të ushtrojë prostitucion përkundrejt fitimit material. Në këtë kontekst rezulton se, element thelbësor i prostitucionit është marrja e shpërblimit për ushtrimin e tij. **Subjekti** i veprës penale, është i përgjithshëm, çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, pra të jetë mbi 14 vjeç dhe që është i përgjegjshëm përpara ligjit. **nga ana subjektive**, autori i veprës të veprojë me dashje, me qëllim përfitimi personal.
29. Gjykata e gjen me vend të theksojë se, barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili duhet nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t’i krijojë gjykatës bindjen “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*” se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri. Nga ana e tij, i pandehuri nuk ka asnjë detyrim që të provojë pafajësinë e tij, megjithatë, ai gëzon të drejtën të mbrohet në procesin penal, në përputhje me procesin e rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ. Lidhur me standardin e vlerësimit të provave GJEDNJ, në **çështjen Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë** shprehet se: “*Për të vlerësuar provat e faktit, Gjykata adopton standardin e të provuarit “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, por shton se prova të tilla duhet të ndiqen nga bashkëekzistenca e deduktiveve përkuese, mjaftueshmërisht të fortë dhe të qartë ose nga prezumime të njëjta e të pakundërshtueshme të faktit.*”. Gjithashtu, Gjykata për të përcaktuar faktin kriminal, është e detyruar të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë parashikuar nga neni 4 të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht se: “*1. I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit*”.
30. Në rastin konkret rezulton e provuar se, në datën 01.06.2018, rreth orës 19.00, në qendrën estetike ku ishte e punësuar e pandehura është futur për të bërë masazh, personi me inicialet

A.H, i autorizuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve simuluese. Masazhi i tij është kryer nga e pandehura [REDAKTUAR] dhe personi i autorizuar ka regjistruar gjithë komunikimin “audio” që ka patur me të. Nga tërësia e komunikimit midis tyre, rezulton qartë që e pandehura [REDAKTUAR] kundrejt një pagese i ka ofruar personit të autorizuar, shërbimin seksual të “seksit gojor”, të cilin më pas e ka realizuar plotësisht. Gjithashtu nga biseda ndërmjet tyre rezulton ndër të tjera se e pandehura është pyetur nga personi me inicialet A.H, në lidhje me pagesën e masazhit dhe ajo i është përgjigjur se kushton 3.000 lekë/orë, se pagesa kryej po tek ajo. Pasi ai i ka bërë me dije se dëshironte t’i linte një kafe, pra pagesë shtesë përveç tarifës së masazhit, ajo i është përgjigjur se kur lë më shumë lekë tek recepsioni thonë pse ky ja jep këto lekë, pse lë më shumë, ndaj klientët pagesat i lenë gjithmonë në dhoma.

31. Në deklaratimet e datës 11.07.2019, e pandehura [REDAKTUAR] pasi ka dëgjuar regjistrimin e bisedës midis punonjësit të autorizuar dhe një punonjëse të qendrës, ka konfirmuar se kishte qenë pikërisht ajo punonjësjë që kishte realizuar komunikimin me klientin...”.

32. Fakti penal në ngarkim të të pandehurës rezultoi i provuar nga: *“Deklarimet e personave që kanë dijeni lidhur me faktet objekt hetimi, shtetasve [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]; Deklarimet e të pandehurës [REDAKTUAR]; Proces-verbal i kontrollit të vendeve dt.19.09.2018; Proces-verbal i kqyrjes së vendit të ngjarjes dt.19.09.2018, së bashku me tabelën fotografike; Proces-verbal mbi veprimet e transkriptimit të bisedave të një përgjimi ambiental dt.05.06.2018; Proces-verbal për kqyrjen e aparateve telefonike celular të shtetases [REDAKTUAR] dt.19.09.2018; Proces-verbal për kqyrjen e aparatit telefonik celular të shtetases [REDAKTUAR] dt.19.09.2018; Proces-verbal për kqyrjen e të dhënave të internetit të shtetases [REDAKTUAR] dt.19.09.2018; Proces-verbal për kqyrjen e të dhënave të internetit të shtetases [REDAKTUAR] dt.19.09.2018; Proces-verbal për sekuestrimin e provës materiale dt.19.09.2018; Proces-verbal për sekuestrimin e sendeve dt.27.09.2018; Akt ekspertimi kompjuterik nr.608, datë 16.01.2019, i Insitutit të Policisë Shkencore Tiranë, së bashku me një hard disk i markës “Verbatim”, si dhe në tërësi nga aktet e procedimit penal Nr.1789/3/ viti 2018 (e veçuar me vendimin e datës 20 mars 2020).*

33. Sa më sipër, gjykata arrin në përfundimin se provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se e pandehura [REDAKTUAR], e ka kryer veprën penale dhe ajo duhet të deklarohet fajtores për veprën penale të “Prostitucioni”, të parashikuar nga neni 113 i K.Penal.

-Lidhur me caktimin e llojit dhe masës së dënimit.

34. Dënimi penal në të drejtën penale kupton atë masë shtrënguese, që zbatohet nga shteti nëpërmjet Gjykatave, në bazë të ligjit, kundër personave fajtorë që kanë kryer vepër penale. Kriteret dhe parimet themelore që duhet të zbatohet Gjykata në caktimin e një dënimi të caktuar, janë të përcaktuara në mënyrë të përgjithshme, pikërisht në nenin 47 të Kodit Penal.

Konkretisht, në këtë dispozitë, sanksionohet se: *“Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”*.

35. Në mbështetje të parimeve të pasqyruara më lartë, konkludohet se Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit, i referohet në radhë të parë llojit të dënimit dhe kufijve të vendosur në dispozitën ligjore konkrete në bazë të së cilës është bërë cilësimi i veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri.

36. Gjykata, në përcaktimin e llojit dhe masës konkrete të dënimit, në kuadër të respektimit të parimit të individualizimit të dënimit, duhet të vlerësojë këto elementë:

- Llojin dhe kufijtë e dënimit të parashikuar në dispozitën konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal (në rastin konkret parashikohet dënim me gjobë ose burgim deri në tre vjet);
- Rrezikshmërinë e veprës penale (vepra penale paraqet rrezikshmëri shoqërore);
- Rrezikshmërinë e autorit të veprës penale (e pandehura nuk paraqet rrezikshmëri shoqërore, ajo nuk ka qenë e dënuar më parë);
- Shkallën e fajit (në rastin konkret vepra penale është kryer me dashje);
- Rrethanat lehtësuese dhe rënduese (rrethana rënduese në rastin konkret nuk ka).

37. Në lidhje me rrethanat lehtësuese Gjykata mban parasysh një sërë rrethanash të cilat i konsideron të tilla që justifikojnë lehtësimin e dënimit:

- si në fazën e hetimeve ashtu edhe në fazën e gjykimit, e pandehura nuk i është shmangur procedimit penal;
- faktin se ajo ka mbajtur qëndrim pohues dhe pendues ndaj veprës së kryer;
- faktin që e pandehura e ka kryer verpën penale për shkak të kushteve të vështira ekonomike, ajo është kryefamiljare dhe ka tre fëmijë të mitur në ngarkim.

38. Sa më sipër, në analizë të të gjitha rrethanave dhe fakteve të kryerjes së veprës penale, të personalitetit të të pandehurit, Gjykata konkludon në lidhje me individualizimin gjyqësor të masës së dënimit, se në rastin konkret ndaj të pandehurës [REDAKTUAR] duhet të caktohet dënimi me 3 (tre) muaj burgim për veprën penale *“Prostitucioni”*, të parashikuar nga neni 113 i K.Penal. Gjykata thekson se kjo masë dënimi, është një masë e përshtatshme për të pandehurën, në përputhje me veçoritë e tij dhe të veprës penale konkrete, si dhe me

rrethanat në të cilat vepra penale është kryer, duke synuar ruajtjen e një raporti të drejtë mes ndëshkimit të fajtorit dhe mbrojtjes së shoqërisë. Gjithashtu, Gjykata në caktimin e një masë të tillë dënimi ndaj të pandehurës mban parasysh edhe parimin se ashpërsia e një penalteti për një vepër penale të kryer, duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale me ashpërsinë e veprës penale.

39. Në aplikim të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, ulet 1/3 (një e treta) e dënimit duke e dënuar përfundimisht të pandehurën [REDAKTUAR] me 2 (dy) muaj burgim.

– ***Lidhur me caktimin e alternativës së dënimit me burgim për rastin konkret.***

40. Në kreun VII të Kodit Penal nga nenet 58 deri në nenin 65 të tij, parashikohen “*Alternativat e dënimit me burgim*”. Në lidhje me aplikimin e alternativave të dënimit me burgim, Gjykata e gjen me vend që paraprakisht të theksojë se alternativat e dënimit me burgim nuk janë dënime të reja, pasi dënimi në rastin konkret është vetëm një dhe konkretisht, dënimi me burgim. Këto alternativa të vuajtjes së dënimit me burgim janë vetëm forma apo mënyra të veçanta të vuajtjes së dënimit me burgim.

41. Aplikimi i alternativave të dënimit me burgim, lidhet në mënyrë të pazgjidhshme me ekzistencën e vetë dënimit (*Parimi “Nulla poena sine lege”*), si dhe me parashikimin ligjor të tyre. Pra, ashtu sikundër nuk mund të zbatohet një dënim penal që nuk është parashikuar në ligj, nuk mund të aplikohet një alternativë (sanksion në interes të komunitetit) e paparashikuar në ligj.

42. Një nga alternativat e dënimit me burgim është “*Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë*”. Kështu, në nenin 59 të Kodit Penal parshikohet shprehimisht se: “*Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet, mund të urdhëroj, që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale*”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se, kjo formë alternative e vuajtjes së dënimit me burgim aplikohet nga Gjykata kur plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte: **Së pari:** Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor Gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se pesë vjet burgim; **Së dyti:** Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ekziston një nga rrethanat në vijim: i pandehuri paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore; i pandehuri është i mitur apo i moshuar; - i pandehuri ka kushte mendore apo shëndetësore të veçanta; i

pandehuri ka detyrime për punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional; i pandehuri ka përgjegjësi thelbësore për familje; i pandehuri e ka kryer veprën në kushtet e disa rrethanave lehtësuese; i pandehuri ka pasur një sjellje shumë të mirë pas kryerjes së veprës penale. Nga formulimi i nenit 59 të Kodit Penal rezulton, se këto rrethana janë të pavarura nga njëra-tjetra dhe nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën.

43. Duke i`u kthyer rastit konkret, Gjykata vlerëson se e pandehura [REDAKTUAR] i plotëson kushtet për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vendohen e saj në provë, për këto arsye: **Së pari**, e pandehura u dënua përfundimisht me 2 (dy) muaj burgim. **Së dyti**, e pandehura nuk paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore. **Së treti**, mban parasysh faktin se e pandehura nuk i është shmangur gjykitimit dhe ka mbajtur qëndrim pohues dhe pendues ndaj veprës së kryer. **Së katërti**, mban parasysh se ajo është kryefamiljare dhe ka tre fëmijë të mitur në ngarkim dhe veprën penale e ka kryer për shkak të kushteve të vështira ekonomike (për më tepër shih dokumentacionin e ndodhur në dosje). **Së pesti**, sipas standardeve ndërkombëtare të vendosura, përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptësisht dhe të jetë një *extrema ratio* në raste të veçanta, atëherë kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Siç është shprehur edhe Këshilli i Evropës, burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm “kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës”, dhe duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë të cilat nuk e bëjnë këtë. Të gjitha këto rrethana i krijojnë bindjen Gjykatës se, ekzekutimi i vendimit me burgim dhe izolimi për 2 (dy) muaj nga shoqëria i të pandehurës Anila Dervishaj, nuk është i nevojshëm.
44. Për sa i përket afatit të provës në paragrafin 3 të nenit 59 të K.Penal parashikohet se: “Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata”. Në kushtet kur për të pandehurën [REDAKTUAR] gjykata dha një dënim me burgim dy muaj, ajo duhet të vendoset në provë për një periudhë kohe prej 4 (katër) muajsh, me kusht që gjatë kësaj periudhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të mos kryejë vepër tjetër penale. Nëse e pandehura [REDAKTUAR] nuk përmbush detyrimet e vendosura nga Gjykata, atëherë ndaj saj do të veprohet sipas nenit 62 të Kodit Penal nën titullin “**Shkelja e kushteve dhe e detyrimeve gjatë kohës së provës**”.
45. Në zbatim të nenit 60/9 të K.Penal detyrohet e pandehura [REDAKTUAR] të mos shoqërohet me persona të dënuar.
46. Në zbatim të nenit 190 të K.Pr.Penale DVR e markës “Hikvision” dhe bllok me ngjyrë të bardhë dhe shirit të kuq sekuestruar të pandehurit t’i kthehen atij. Ndërsa gjashtë prezerativët me mbishkrimin “Durex”, dhe një kuti ambalazhi të zhduken.

– Lidhur me shpenzimet procedurale.

47. Duke qenë se, e pandehura u deklarua fajtores dhe u dënua për veprën penale për të cilën akuzohet, bazuar në nenin 485 të K.Pr.Penale, shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurës [REDAKTUAR].

Sa më sipër, Gjykata bazuar në nenet 115/1, 113/1, 48 dhe 49 të K.Penal, si dhe në nenet 190, 379, 383, 384, 388/d, 406 të K.Pr.Penale:

VENDOSI

1. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit [REDAKTUAR], për veprën “Mbajtja e lokaleve për prostitucion”, parashikuar nga neni 115 i Kodit Penal.
2. Në zbatim të nenit 389 të K.Pr.Penale, deklarohet heqja e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin nr.1797/1 Akti, datë 18.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
1. Deklarimin fajtores të të pandehurës [REDAKTUAR] për veprën penale “Prostitucioni”, parashikuar nga neni 113/1 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e saj me 3 (tre) muaj burgim.
1. Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurën [REDAKTUAR] me 2 (dy) muaj burgim.
2. Në zbatim të nenit 59 të K.Penal urdhërohet:
 - Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim.
 - Vënia në provë e të pandehurës [REDAKTUAR] për një periudhë kohe prej 4 (katër) muaj, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale.
 - Gjatë kohës së provës, e pandehura [REDAKTUAR] të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë.
 - Afati i kohës së provës për të pandehurën [REDAKTUAR] fillon nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi.
1. Në zbatim të nenit 60/9 të K.Penal detyrohet e pandehura [REDAKTUAR] të mos shoqërohet me persona të dënuar.
1. Në referim të nenit 190 të K.Pr.Penale DVR e markës “Hikvision” dhe bllok me ngjyrë të bardhë dhe shirit të kuq sekuestruar të pandehurit t’i kthehen atij. Ndërsa gjashtë prezerativët me mbishkrimin “Durex”, dhe një kuti ambalazhi të zhduken.
1. Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë për të kontrolluar e verifikuar respektimin e detyrimeve të dhëna me këtë vendim nga e pandehura.
1. Shpenzimet procedurale gjatë hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore të parapaguara nga shteti lihen në ngarkim të të pandehurës [REDAKTUAR].

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot më datë 23.07.2020.

SEKRETARE

GJYQTARE

Elisabeta Tusha

Oltjona GOXHA

Shpenzime gjyqësore

Njoftime: 450 lekë

Seancë paraprake: 3300 lekë

Shpenzime hetimi: 7.272 lekë